

Njoftim Publik

Në Drejtorin e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni 05 nr. 350 /02 - 224787/19 dt.12.09.2019, për caktimin e kushteve ndërtimore, të pronarëve, **Isa Berisha, Ymrane Pangja, Avni Berisha, Prime Group Construction Sh.p.k** nga Prishtina dhe investitorit "**Prime Group Construction**" sh.p.k. nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleks me ndërtesë shumë banesore & afariste –"Objekti A", "B", "C", "D", në kuadër të Bllokut urban "E-11" të Tërësisë "E", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perendim" në Prishtinë.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr.04/L-110 dt.31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënjes së lejes së ndërtimit".

Komentet lidhur me këtë projekt propozim të dorëzohen nga data: **22.10.2019** gjerë **05.11.2019**, në Email-in adresën : urbanizmpishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – "Objekti A", "B", "C", "D",	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Arë e klasit 4 (Ndërtim i lartë)
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues = 3.5m`
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues = 5.0m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ 11.42 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	~ 6.45 m` ~ 7.55 m` ~ 6.95 m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=34%
g. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=20 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=1.8, ose ~ 8,304.7 m ²
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN = 41%
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	72 VP brenda dhe jashtë ndërtesave
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	PO
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	PO
m. A ka qasje të pakufizuara në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të UA 06/2017, dt.23.05.2017 të MMPH-së, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përkrahjet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

